



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KOMUNËS**

14-030/01-61906/22, më 18. 03. 2022

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Memorandumit të Mirëkuptimit me nr. 14-030/01-0175192/20, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

**V E N D I M**

- I. Miratohet vendimi për emërimin e dy (2) anëtarëve nga Komuna e Prishtinës, të cilët do të jenë pjesë e Bordit Drejtues të Institutit “UPCO Cluster”, të themeluar bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me nr. 14-030/01-0175192/20.
- II. Të emëruarit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
  1. Teuta Sahatqija – Këshilltare për transformim digjital në kabinetin e Kryetarit;
  2. Ridvan Islami – Udhëheqës i Qendrës për këshillim në karrierë, Drejtorja për Arsim.
- III. Bordi Drejtues ka përgjegjësi të plotë për çështje të politikave dhe financave të organizatës si dhe kompetenca dhe detyra të tjera të përcaktuara me Statutin e Institutit “UPCO Cluster”.
- IV. Mandati i anëtarit të Bordit Drejtues mund të përfundojë para kohe në rast të:
  - a) dorëheqjes me shkrim;
  - b) zëvendësimit nga institucioni që e ka deleguar;
  - c) vdekjes.
- V. Për kryerjen e detyrës si në pikën III të këtij Vendimi, të emëruarit i raportojnë Kryetarit të Komunës.
- VI. Puna e anëtarëve të Bordit Drejtues është vullnetare. Pagesa ose kompensimi mund të bëhet vetëm atëherë kur është i arsyeshëm dhe për punën e kryer për organizatën.

VII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi me nr. 14-102/03-61887/22, të dt.18.03.2022.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET:**

- Të emëruarve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Përparim Rama**

